

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRRI

02 Nr. / Br. 604/18

No. / fq. / Br. sh.

Data: / Datum: 03.05.2018

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Kryetari

Bazuar në nenin në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësi të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221 dhe ligjin nr. 04/L-116 neni 6 si dhe rregullën Financiare nr. 01/2010 dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr :

V E N D I M  
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

1. Me këtë vendim formohet grupi punues për përgatitjen “Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”.
  - 1.1 z. Abit Abiti , Koordinator i grupit,
  - 1.2 znj. Albulena Tahiri, Zyrtare për pranimin e faturave,
  - 1.3 znj. Azize Krasniqi, Zyrtare zotuese –Administratë,
  - 1.4 znj. Lule Zeqiri, zyrtare zotuese – Arsim,
  - 1.5 znj. Adlije Trepça, zyrtare zotuese – Shëndetësi,
  - 1.6 z. Xhafer Islami, zyrtar i Prokurimit,
  - 1.7 z. Nexhat Merovci, Mbikëqyrës i projekteve,
  - 1.8 znj. Merita Mulaku, Zyrtare certifikuese.
2. Detyra e grupit është përgatitja e “Librit e Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”.
3. Qëllimi i këtij libri të proceseve është , të përshkruaj proceset e punës në fushën e menaxhimit të financave publike, listën e proceseve, përshkrimin e aktiviteteve mbrenda procesit, diagramet (paraqitja skematike e ndërlidhjes mes organizatave), identifikimin e rreziqeve si dhe aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin si dhe minimizimin rreziqeve.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorit për Buxhet dhe Financa, anëtarëve të grupit punues, dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br. 627 / 18

Nr. / Sq. / Br. at \_\_\_\_\_

Data: / Datum 14.05.2018

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës me nr.600185202 datë:26.04.2018 në shumë prej 398.00€ (treqindënëntëdhjetetëeuro) për shpenzimet e krijuar në "Bajraktari" SH.P.K Maxhunaj - Vushtri, darkë me rastin e vizitës së delegacionit nga Vaxjo –Suedi dhe përfaqësues nga Komuna.
2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Zyrës Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është fatura dhe kuponi fiskal i bashkangjitur në shtojcë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 9 pika 1 Të Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare të Organizatave Buxhetore, nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, nenit 15 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare të Komunës 02Nr.464/14 dt.20.03.2014, si dhe raportin e komisionit për vlerësim të pasurisë jo financiare të komunës Nr.16549/18, dt. 06.04.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR TJETËRSIM TË PASURISË JOFINANCIARE TË KOMUNËS

1. Themelohet Komisioni për tjetërsim të pasurisë jo financiare të Komunës në këtë përbërje:
  - 1.1 Ilirijana Azemi, kryesuese e komisionit
  - 1.2 Besim Demiraj, anëtar
  - 1.3 Liridon Lahu, anëtar
2. Komisioni në fjalë do të zbatoj procedurat e tjetërsimit të pasurisë jo financiare të komunës duke u bazuar në nenin 9 pika 3-10 të Rregullores së MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore, përkatësisht nenit 14-17 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës 02nr.464/14, dt. 20.03.2014 si dhe raportin e Komisionit për vlerësim të pasurisë jo financiare të komunës i cili është i bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi,
3. Komisioni për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare të komunës do të njoftoj zyrtarin për regjistrim të pasurisë së komunës dhe dorëzoj një kopje të të gjithë dokumentacionit lidhur me procesin e tjetërsimit.
4. Vendimi hyn ë fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Anëtarëve të komisionit, Drejtorit për Buxhet dhe Financa, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, “g” të Statutit të Komunës, si dhe për shkak të kufizimeve buxhetore gjegjësisht mungesës së mjeteve të mjaftueshme buxhetore për v. 2018, Kryetari i Komunës merr :


### V E N D I M

1. Mjetet financiare nga buxheti i zyrës së kryetarit të komunës – programi subvencione dhe transfere për vitin 2018, mund të shfrytëzohen për ndihmë emergjente vetëm për raste e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në shtëpitë (objektet) e banimit në të cilat nuk është i mundur renovimi dhe banimi në të njëjtat për shkak të shkallës së lartë të dëmtimit.
2. Komisioni Komunal për Vlerësim të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera do të i procedoj për shqyrtim te kryetari i komunës vetëm kërkesat për kompensim të dëmeve siç janë cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të vlejë për periudhën kohore 01 janar 2018 deri me marrjen e një vendimi tjetër i cili do ta shfuqizonte këtë vendim.
4. Vendimi i dërgohet: Kryesuesit të Komisionit për Vlerësim të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës  
  
Xhafer Tahiri



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 70 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe në bazë të nenit 9 të rregullores nr.04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil, Kryetari i Komunës, bien:

## V E N D I M

**Për emërimin e komisionit disiplinor për shërbimin civil të komunës së Vushtrrisë**

I. Me të cilin vendim emërohet komisioni disiplinor për shërbimin civil të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.Mentor Jashari, kryesues i komisionit
- 2.Hashim Hajrizi, anëtar i komisionit,
- 3.Hadika Abdurrahmani, anëtare e komisionit.

II. Komisioni ka mandat 2 vjeçar.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITAN

02 Nr. / Br. 656/18

Nr. i fq. / Br. sh. \_\_\_\_\_

Data / Datum 15.05.2018

VUSHTRRIË - VUÇITAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nein 8 pika 2, 3 dhe 4 të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe nenin 67 “P” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr,

V E N D I M


PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE PËR OJQ

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësim të aplikacioneve sipas thirrjes publike të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport të datës 28.03.2018 për ndarje të subvencioneve për OJQ-të për vitin 2018.
2. Komisioni Vlerësues ka këtë përbërje:
  - 2.1 z. **Naim Ferizi**, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, - Kryesues
  - 2.2 z. **Ekrem Miftari**, Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport, - anëtar
  - 2.3 z. **Rexhep Gërguri**, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, - anëtar
  - 2.4 z. **Avni Deliu**, Shoqëria Civile, - anëtar
  - 2.5 znj. **Fikrije Ferizi** OJQ “Ato” - anëtar
  - 2.6 z. **Berat Januzi**, Drejtorja për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, zëv.anëtar
3. Anëtar i rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për subvencion.
4. Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfituesve do të zbatoj procedurat nga neni 16-21 të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve,
5. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision. Këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
6. Komisioni Vlerësues ka mandat deri në fund të vitit 2018.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
8. Vendimi i iu dërgohet: Drejtorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoreshës për Kulturë Rini dhe Sport, anëtarëve të Komisionit Vlerësues dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Në mungesë të mjeteve financiare në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjete financiare në shumë prej 5944.26 € nga Drejtoria për Shërbime Publike që do të shfrytëzohen për mbulim të shpenzimeve me rastin e organizimit të ceremonisë së binjakëzimit të Komunës së Vushtrisë me Qytetin Norwalk, të IOWA-s – SHBA.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Arkivit të Sekretarisë.

  
Kryetari i Komunës  
  
Xhafer Tahiri




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Nënkyetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. z. Salih Tahiri, zyrtar i komunës së Vushtrrisë, i lejohej pagesa e mëditjeve për udhëtim zyrtar në Shkup, Maqedoni me datën 06 maj 2018 dhe 09 maj 2018.
2. Pagesa e mëditjeve të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Nënkyetari i Komunës

Besim Muzaqi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

GZ Nr. / Br. 605/18

Nr. / Fa. / Be. st.

Datar / Datum 17.05.2018

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Nënkyetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. z. Xhafer Tahiri, kryetar i komunës së Vushtrrisë, i lejohej pagesa e mëditjeve për udhëtim zyrtar në Vaxjo - Suedi nga data 06 deri 09 maj 2018.
2. Pagesa e mëditjeve të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Nënkyetari i Komunës

Besim Muzaqi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN

QZ Nr. / QZ \_\_\_\_\_ 689/18 \_\_\_\_\_

Nr. / Qa. / Dës. \_\_\_\_\_

Data: / Datum \_\_\_\_\_ 22.05.2018 \_\_\_\_\_

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. z. Rrahim Muli, zyrtar në Drejtorinë për Shërbime Publike, i lejohe pagesa e mëditjes për udhëtim zyrtar në Tiranë – Shqipëri me datën 19 prill 2018.
2. Pagesa e mëditjes të bëhet nga buxheti i Drejtorinë për Shërbime Publike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës  
  
Xhafer Tahiri





REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr. / Br. 690/18

Nr. i fq. / Br. at \_\_\_\_\_

Data: / Datum: 22. 05. 2018

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. znj. Rabije Zahiti, zyrtare në Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, i lejohet pagesa e mëditjeve për udhëtim zyrtar jashtë Kosovës - Novi Sad me datën 15 dhe 16 maj 2018.
2. Pagesa e mëditjeve të bëhet nga buxheti i Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


### V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës me nr.0107518 datë:13.04.2018 në shumë prej 79.00€ (shtatëdhjetenëntëeuro) për shpenzimet e krijuar në D.P.H “Prestige”- Vushtrri, drekë zyrtare me rastin e vizitës së delegacionit nga Iowa –Amerikë, stafi udhëheqës i Komunës si dhe zyrtar nga Drejtoria e Arsimit.
2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Drejtorisë për Arsim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Arsim dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA  
**KOMUNA VUSHTRRI**  
VUSHTRRI MUNICIPALITY /OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 22.05.2018merr këtë:

## **VENDIM PRELIMINAR**

### **Neni 1.**

**KONSTATOHET** se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për asfaltimin e rrugës në Lagjën Parduzi-Muli në fshatin Kuvovik, Komuna Vushtrri për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202068-00284-0 në sipërfaqe prej 1157 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 27729 m<sup>2</sup>, ZK-Ceceli, pronar në pjesë ideale 1/1 Isak Zymer Musiqi nga Cecelia, Komuna Vushtrri.
- P-70202068-00286-0 në sipërfaqe prej 2049m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6877 m<sup>2</sup>, ZK-Ceceli pronar me pjesë ideale 1/1 Isak Zymer Musiqi nga Cecelia, Komuna Vushtrri.

### **Neni 2**

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

### **Neni 3**

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore “Kosova Sot” në Kosovë.

### **Neni 4**


Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, konform nenit 35 paragrafi 3 të

Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

#### **Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore "Kosova Sot" në Kosovë.

  
Kryetari i Komunës  
  
Xhafer Tahiri



*Translated: Albanian-English*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA VUSHTRRI  
VUSHTRRI MUNICIPALITY /OPSTINA VUCITRN

Pursuant to Articles 11 and 13 of the Law on Local Self-Government no. 03 / L-040, and Article 4, Article 10 of the Law on Expropriation of Immovable Property, no. 03 / L-139, as amended by the Law No.03 / L-205 of 28.10.2010 and Article 67 "g" of the Statute of the Municipality, Mayor of the Municipality as an expropriating body on 22.05.2018,

**PRELIMINARY DECISION**

**Article 1**

CONCLUDED: that the conditions set out in sub-paragraphs 1.1 to 1.4, paragraph 1 of Article 4 of the Law on Expropriation of Immovable Property, are fulfilled, the Amendments to the Law 03 / L-139 with No.03 / L-205 dated 28.10.2010, on the Expropriation of Immovable Property with the purpose to obtain a legitimate Public Benefit - Realization of the road pavement project in the Neighborhood Parduzi - Muli in Kunovik village, Municipality of Vushtrri for the parts of cadastral parcels as follows:

- P-70202068-00284-0 area of 1157 m<sup>2</sup>, with a total area of 27729 m<sup>2</sup>, ZK-Ceceli, owner in ideal part 1/1 Isak Zymer Musiqi from Cecelia, Municipality of Vushtrri.
- P-70202068-00286-0 with an area of 2049m<sup>2</sup>, with a total area of 6877 m<sup>2</sup>, ZK-Ceceli owner with ideal parts 1/1 Isak Zymer Musiqi from Cecelia, Municipality of Vushtrri.

**Article 2**

Within 5 working days after the adoption of this decision, the owner / property owner of the property that will be expropriated will be notified with the preliminary decision.

**Article 3**

Within 10 working days after the approval, the preliminary decision will be published in the Official newspaper of the Republic of Kosovo and in the daily newspaper "Kosova Sot" in Kosovo.

**Article 4**

An appeal can be filed against this decision within 15 days after its entry into force in the Basic Court in Mitrovica - Branch in Vushtrri, in conformity with Article 35 paragraph 3 of the Law on Expropriation of Immovable Property, No. 03 / L-139 with Amendments to the Law No.03 / L-205 of 28.10.2010. An appeal can be filed by the owner, or owner of the interest on the property affected by this decision. On the same day that a complaint is submitted to the Court, the complainant must immediately and directly submitted 5 (five) complete copies of the complaint to the legal office, of the expropriating authority (Municipality of Vushtrri), including all supporting documents justifying the complaint.

**Article 6**

The decision enters into force on the day of its publication in the Official Newspaper and in the daily newspaper "Kosova Sot" in Kosovo.

Mayor of the Municipality



Xhafer Tahiri







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIŠ - OPŠTINA VUÇITRN	
QZ Nr./Br	693 /18
Nr./Ep./Br.st	- 02 -
Data/ Datum	22.05.2018
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**  
**REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA VUÇITRN**

Na osnovu člana 11 i 13 Zakona o Lokalnom Samoupravljanju br. 03/L-040, člana 4,i člana 10 Zakona o Ekspropriaciji Nepokretne Imovine Br. 03/L- 139 sa izmenama i dopunama Zakona Br. 03/L-205 dana 28.10.2010 god, kao i člana 67 "g" Statuta Opštine, Predsednik Opštine, kao eksproprisani organ dana 22.05. 2018. god, donosi ovu:

**PRELIMINARNU ODLUKU**

**Član 1**

1. **UTVRĐUJE SE** da su ispunjeni uslovi utvrđenih u pod-paragrafu 1.1 do 1.4 paragraf 1, član 4 Zakona o Ekspropriaciji Nepokretne Imovine br. 03/L-139 sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205 od dana 28.10.2010 god, za eksproprijaciju nepokretne imovine, u cilju zakonske javne koristi –za realizaciju projekta za asfaltiranje puta u naselje Parduzi- Muli u selo Kunovik ,Opština Vuçitrn, za deo katastarske parcele kao što sledi :

- P-70202068 -00284-0 u površini od 1157 m<sup>2</sup>, od ukupne površine od 27729 m<sup>2</sup>. KZ- Ceceli, sa vlasniokom na idealnom delu 1/1 Isak Zymer Musiqi iz Cecelije, Opština Vuçitrn.
- P-70202068-00286-0 u površini od 2049 m<sup>2</sup>, iz ukupne površine od 6877 m<sup>2</sup>, KZ – Ceceli, vlasnik u idealnom delu 1/1 Isak Zymer Musiqi iz Cecelije , Opština Vuçitrn.

**Član 2**

Unutar 5 radnih dana nakon usvajanja ove odluke, biće informisan preliminarnom odlukom vlasnik/nosilac imovine koja će se eksproprisati

**Član 3**

Unutar 10 radnih dana posle usvajanja, preliminarna odluka biće objavljena na Službenom Listu Republike Kosova i na Dnevnom Listu "Kosova sot" na Kosovu.

#### Član 4

Protiv ove odluke može se podneti žalba unutar 15 dana posle stupanja na snazi, u Osnovnom Sudu u Mitrovici, filijala u Vučitrnu, u skladu člana 35 paragraf 3, Zakona o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine Br 03 L/139 sa izmenama i dopunama Zakona br.03/L-205 dana 28.10.2010.god. Žalba se može podneti od vlasnika ili nositelja interesa po ovoj odluci. Istog dana kada se predaje žalba u Sudu, podnosilac žalbe treba odmah i direktno predati u Zakonskoj Kancelariji organa eksproprijacije (Opštini Vučitrn) 5 (pet) tačnih i punih kopija žalbe, uključujući sve prateće dokumentacije koji opravdavaju žalbu.

#### Član 5

Odluka stupa na snagu danom objavljivanja na Službenom listu i na Dnevnom listu "Kosova sot" na Kosovo.

  
**Predsednik Opštine**  
  
**Xhafer Tahiri**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

QZ Nr. / By 704/18

Nr. / Sp. / Dk. st \_\_\_\_\_

Data / Datum 28.05.2018

VUSHTRRI - VUČITRAN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe Nenin 14 pika 1. të Rregullores 01nr.86/15, dt. 30.04.2015, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Formohet komisioni për shqyrtim të ankesave për ndarje të bursave të studentëve për vitin akademik 2017/2018, në këtë përbërje:
  - 1.1 z. **Agim Miftari** – kryesues i komisionit,
  - 1.2 z. **Hashim Hajrizi**, anëtar,
  - 1.3 z. **Ilmi Zeqiri**, anëtar.
2. Komisioni në fjalë ka për detyrë që të shqyrtoj ankesat në konkursin e shpallur për ndarje të bursave për studentë, për vitin akademik 2017/2018 – konkursi 10nr.271/18, dt. 03.04.2018. Komisioni pas shqyrtimit të ankesave duhet të vendos lidhur me ankesat brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës/ave.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: Drejtorit për Arsim, Anëtarëve të Komisionit për Ankesa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri